

**L I G J**  
**Nr.8152, datë 12.9.1996**

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1588, DATË 3.9.1996 “PËR DISA  
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8083, DATË 7.3.1996, NDRYSHUAR ME  
DEKRETIN NR.1511, DATË 29.6.1996”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

**KUVENDI POPULLOR  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1588, datë 3.9.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr.8083, datë 7.3.1996, ndryshuar me dekretin nr.1511, datë 29.6.1996, si më poshtë:

- Në nenin 1 të dekretit bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin me shkronjën a), rreshti i katërt:

“ - Letër cigare për shitje .....50” hiqet

- Pika c) bëhet: “pije joalkoolike, freskuese e të tjera”.

- Në pikën e) fjalët “Alkool etilik prodhim vendi” bëhen: “Alkool etilik i pastër importi”.

Paragrafi: “Për letrën e cigares, të importuar nga subjektet e ndryshme ekonomike që duhet për nevojat e prodhimit, të mos zbatohet akciza në doganë”, hiqet.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1614, datë 19.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**